



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|---|-------------------------------------|------------------------------|-----------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodatori Received/Delivered | 23-01-2023 | viti god year | |
| Organ / Njesia Organ / Jednitsa Org / Unit | Rr / Prad Rr / Prad Rr / Prad | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kohëzgjatësi Quantity |
| SKRINSHK | 719/2023 | | 118 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1042/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.1042/2022 të datës 23.11.2022, të parashtruar nga ankuesi Ejup Kamberaj nga Prishtina, kundër Vendimit me Nr.146/2022 të datës 10.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike “transferim për shkak të riskstrukturimit”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1042/2022 e datës 23.11.2022, e parashtruar nga ankuesi Ejup Kamberaj.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.146/2022 të datës 10.11.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

A r s y e t i m

Ankuesi Ejup Kamberaj, më datë 23.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7334/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.146/2022 të datës 10.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, më datë 13.12.2022 Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër VK.nr.204/2022 të datës 28.12.2022, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.Nr.1042/2022 e datës 23.11.2022, të parashtruar nga ankuesi Ejup Kamberaj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7334/2022 të datës 23.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr.146/2022 të datës 11.11.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr.139/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Emailin e datës 27.12.2022 të ankuesit drejtuar J.Koca; Akt emërimi me nr.prot.219/2014 i datës 10.03.2014; Emailin e datës 20.06.2022 të E. Kamberi drejtuar Sh.Leci; Përgjigjen me numër të protokollit 1060 të datës 25.03.2022 të ankuesit drejtuar Udhëheqësit të Personelit të MPJD-së; Certifikatën e lëshuar nga Fokus &1 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze niveli Pre-intermediate; Certifikatën e lëshuar nga Fokus &1 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze niveli elementary; Certifikatën e lëshuar nga Fokus &1 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze niveli Biginner; Certifikatën e lëshuar nga Ketnet lidhur me ndjekjen e 58 orëve të anglishtes së përgjithshme niveli A2-B1; Certifikatën me Nr.123/05 të datës 16.05.2005; Vërtetim i lëshuar Zyra e Kryeministrit me nr.866 e datës 13.09.2004; Letër rekomandimi për Ejup Kamberaj e lëshuar nga Zyra e Presidentit të Kosovës e datës 24.05.2004; Vërtetim i marrëdhënies së punës me nr.ref.11.1.289/15 e datës 10.06.2015; Letër rekomandimi e lëshuar nga UNMIK e datës 27.07.2004; Letër rekomandimi për Ejup Kamberaj me nr.587/2005 e datës 12.09.2005; Emailin e datës 19.09.2022 të ankuesit drejtuar Sh.Leci; Emailin e datës 14.11.2022 të ankuesit drejtuar Sh.Leci; Emailin e datës 20.06.2022 të ankuesit drejtuar Sh.Leci; Certifikatën nën shenjen Dip-6053-II/86 të datës 13.06.2003 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatën me Nr.03/7001 të datës 04.01.2006; Shkresën nën shenjen 7186/2015 lidhur me noterizimin e dokumentit; Shkresën me numër 01-07-399/17 të datës 31.01.2017; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen e trajnimit në muajin Mars-2016; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Menaxhimi i Asistencës Financiare të BE-së Qershor 2017; Certifikatën lidhur me vijimin e trajnimit kushtetues për periudhën kohore 07.01.-17.01.2002; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Ligji për Zyrtaret Publik-ristit dhe ndryshimet në Administratën Publike"; Formular i vlerësimit për nëpunësit e jashtëm për vitin 2021(deri në muajin gushtë); Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 20.12.2018; Formular i vlerësimit e rezultateve në punë për periudhën shtator-dhjetor 2019 e datës 27.12.2019; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesionale i datës 29.01.2021; Emailin e datës 24.10.2022 nga ankuesi drejtuar D.Gervalla; E-mailin e datës 21.10.2021 të ankuesit drejtuar D.Gervalla; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 7536/2022 të datës 01.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 7956/2022 të datës 13.12.2022; Aktin e emërimit me numër ref.219/2014 të datës 10.03.2014; Formularin e përshkrimit të punës (pa numër dhe datë); Raportin e veçantë të Komisionit të Ristrukturimit me numër protokollit 1620 i datës 01.11.2022; Përshkrimin e vendeve të punës për propozimin numër 1; Konkursi me nr.reference RN00006214 për pozitën "Drejtori i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm"; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Drejtor i Arkivit Ndërkomunal në Prishtinë"; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i

Avancimit për të Drejtat e Njeriut ; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Koordinimin e Nismave Rajonale”; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Drejtor i Drejtorisë së Administratës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë”; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Udhëheqës i Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore”; Vendimin me numër VK.nr.204/2022 të datës 28.12.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, *Sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me ç’rast si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve për pozita të caktuara. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje referuar Komisioni i Ristrukturimit), kurse, me Vendimin me shenjë VPD Nr.01/2022 të datës 16.03.2022 ka miratuar përshkrimin e detyrave të punës të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtës të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Me tej nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi Ejup Kamberaj në bazë të Akt Emërimit Nr.Ref.219/2014 të datës 10.03.2014, ka qenë i emëruar në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në ish Ministrinë e Diasporës*, e cila pozitë është paraparë edhe me Rregulloren Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo që për këtë pozitë kanë ndryshuar kriteret e vendit të punës respektivisht janë përcaktuar kriteret shtesë lidhur me kualifikimet e posaçme formale, rrjedhimisht si kriteret për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: *Diplomë/a të studimeve universitare: Juridik, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohja e gjuhës angleze në nivelin B1-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze.*

Komisioni i Ristrukturimit përmes Raportit me numër protokollit 596 të datës 19.04.2022 ka konstatuar së ankuesi ka plotësuar kriteret e posaçme lidhur me arsimin dhe përvojën e punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit, mirëpo, i njëjti nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale lidhur me njohjen e gjuhës angleze, kështu që mbi këtë bazë Komisioni ka bërë propozim të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ankuesi të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, kurse me Raportin plotësues me numër protokollit 615 të datës 22.04.2022 ka propozuar që ankuesi të transferohet në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila pozitë është vendosur si e lirë në listën e pozitave të lira të përcjella nga DMZP-ja, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes

Vendimit Nr.139/2022 të datës 15.09.2022 ankuesin e ka transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ankuesi më datë 10.07.2022 kishte parashtruar ankesë me numër protokolli 4158/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër heshtjes administrative lidhur me mos transferimin e ankuesit në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit, ndërsa Këshilli më Vendimin me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka anuluar Vendimin Nr.139/2022 të datës 15.09.2022 për transferimin e ankuesit Ejup Kamberaj dhe ka kthyer çështjen në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, më Raportin e Veçantë me numër protokolli 1620 të datës 01.11.2022 ka konstatuar se ankuesi nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme lidhur me pozitat e lira të Udhëheqëseve të Divizioneve. Rrjedhimisht, Komisioni i Ristrukturimit propozon që ankuesi meqenëse nuk plotëson kriteret për asnjërën nga pozitat e lira të nivelit të ulet drejtues, të transferohet në një institucion tjetër të Shërbimit Civil, duke rekomanduar që ankuesi të sistemohet në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Bazuar në propozimi e Komisionit të Ristrukturimit, Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 10.11.2022 ka nxjerr Vendimin me Nr.146/2022 të datës 10.11.2022 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.146/2022 të datës 10.11.2022 lidhur me transferimin për shkak të ristrukturimit të institucionit, pretendon se procedura e transferimit ka të bëjë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike sepse Komisioni për Ristrukturim nuk ka arritur të bëjë shqyrtimin e detajuar të rastit, transferimi është në kundërshtim të plotë me nenin 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët publikë si dhe nenin 14 të Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ngase pozita e ankuesit nuk është shuar dhe se ankuesi ka mbi 29 vite përvojë pune në institucionet publike dhe se ka gradë akademike magjistër i shkencave juridike. Tutje ankuesi thekson së aprovimi i kualifikimeve shtesë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit është antiligjore sepse edhe në ministrit tjera nuk ka kriteret të standardizuar lidhur me kriteret e veçanta. Propozon që Këshillit të aprovoj ankesën si të bazuar, të anulohet vendimin me numër VK.01/2020 të datës 16.03.2022 të Zëvendësueses së Drejtores së DMZP-së dhe ankuesi të caktohet në pozitën e punës se Udhëheqësit të Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 13 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, me të cilin është përcaktuar se: *"1.Raste të mbylles apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës"* dhe si rrjedhojë bazuar në

frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson së rishikimi është proces i ndryshimit të organizimit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit kanë pësuar ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës. Nisur nga ky fakt, Kolegji konstaton se si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës, është bërë riorganizimi i këtyre dy ministrive i materializuar me Rregullores Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe si rrjedhojë e riorganizimit ka pas shuarje të pozitive të caktuara të punës, krijim të pozitive të reja të punës si dhe ndryshime të kriterëve për pozita të caktuara. Gjegjësisht, ndërlidhur me këtë Kolegji i Këshillit duku u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të miratuar nga DMZP-ja lidhur me pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit (pozitë të cilën e ka mbajtur ankuesi para rishikimit) ka pas ndryshime të kriterëve të punës përkatësisht janë përcaktuar kriter shtesë lidhur me kualifikimet e veçanta duke vendosur si kriter *njohjen e gjuhës angleze*, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton së nuk është i bazuar pretendimi ankimor se nuk janë plotësuar kushtet e ankuesit për transferim.

Përkitazi me pretendimin ankimor se aprovimi i kriterëve të veçanta për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit është i kundërligjshme pasi që nuk ka kriterë të standardizuara, Kolegji ju referuar dispozitive të Rregullores përkatësisht nenit 18 paragrafi 2 me të cilin është përcaktuar se: *2. Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkesat për zotërimin e arsimit që përfshijn nivelin dhe fushën e arsimit, kualifikimin apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për atë pozitë përkatëse (psh. provimin e jurisprudencës apo ndonjë certifikim tjetër), përvojës profesionale domethënëse në profesion dhe/apo në punë apo kushteve të tjera specifike (psh. zotërimi një certifikimi për një gjuhë të huaj, etj., si dhe nenit 19 me të cilin është paraparë se: Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të pozitës së punës. 2. Përshkrimi i punës shërben për: 2.1. të njohur nëpunësin civil me punën që duhet të kryejë; 2.2. vlerësinin dhe klasifikimin e pozicionit të punës; 2.3. vlerësinin e rezultateve në punë; 2.4. përcaktimin e kërkesave të veçanta për çdo pozicion pune në shërbimin civil. 3. Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucionit...."* andaj, mbi këtë bazë ligjore, Kolegji i Këshillit vlerëson së çdo organizimin i brendshëm i një institucioni publik ndiqet dhe përcaktohet nga misioni dhe fushëveprimi i tij kushtetues apo ligjor, kështu që nisur nga ky konstatim, e duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, sipas të cilit Ministria e Punëve të Jashtme është dikaster qeveritar përgjegjës që të zbatoj politikën e jashtme të Republikës së Kosovës si dhe të përfaqësoj Republikën e Kosovës dhe institucionet e saj shtetërore në vendet e jashtme dhe në organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare, rrjedhë së njohja e gjuhëve të huaja është e nevojshme për ushtrimin e këtyre funksioneve, andaj vendosja e kualifikimeve të posaçme lidhur me një pozitë në pajtim me specifikat e institucionit është ligjërisht i bazuar.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar si me lartë, vlerëson së Komisioni i Ristrukturimi me rastin e përgatitjes së raportit me numër protokollit 1620 të datës 01.11.2022 ndërlidhur me ankuesin, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe ka vepruar në pajtim me ligjin material, sepse duke u bazuar në shqyrtimin të provave të lëndës Kolegji ka konstatuar së ankuesi sipas Akt Emërimit Nr.Ref.219/2014 të datës 10.03.2014, ka qenë i emëruar në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në ish Ministrinë e Diasporës*, pozitë e përcaktuar edhe me Rregulloren Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo për pozitën e njëjtë kanë ndryshuar kriteret e përgjithshme formale. Rrjedhimisht sipas përshkrimit të detyrave të punës të miratuar nga DMZP-ja, për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit si kriteret janë vendosur: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare: Juridik, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohja e gjuhës angleze në nivelin B1-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze.* Në kuptim të plotësisht të kriterëve për këtë pozitë të punës, Kolegji bazuar në shqyrtimin e dosjes personale të ankuesit ka gjetur së i njëjti ka plotësuar kriterin e arsimit dhe përvojës së punës por jo edhe kualifikimet e veçanta lidhur me njohjen e gjuhës angleze, gjegjësisht ankuesi lidhur me njohjen e gjuhëve të huaja posedon certifikatat e lëshuar nga Shkolla e Gjuhëve të huaj "Fokus & I" lidhur me përfundimin e nivelit të gjuhës angleze Beginner, Elementary, dhe Pre-Intermediate, si dhe certifikatën e lëshuar nga "Ketnet" lidhur me ndjekjen e trajnimit të Anglishtes së Përgjithshme të nivelit A2-B1, pra ankuesi nuk posedon dëshmi lidhur me njohjen e gjuhës angleze të nivelit B1-C1, si kërkesë e detyrueshme për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji i Këshillit po ashtu ka analizuar edhe kriteret lidhur me pozitat e kategorisë së ulët drejtuese që kanë qenë të lira në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në përfundim të ristrukturimit gjegjësisht për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Evropë dhe BE si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca Politike, Studime Evropiane, Juridik, Ekonomik, Shkenca tjera shoqërore me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës Angleze, Frënge ose Gjermane në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në këto gjuhë ose në një universitet jashtë vendit në këto gjuhë.* Udhëheqës i Divizionit për Amerikën Qendrore dhe Jugore si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: *Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca Politike, Juridik, Ekonomik, Filozofik, Filologjik, Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze ose spanjolle në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze ose spanjolle, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në këto gjuhë ose në një universitet jashtë vendit në këto gjuhë.* Udhëheqës i Divizionit për Organizatën e Kombeve të Bashkuar si kualifikime të posaçme janë përcaktuar *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Juridik, Ekonomik ose Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Tjetër: Kualifikime të posaçme formale Njohje e ndonjë prej gjashtë(6) gjuhëve zyrtare të OKB-së, në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura. Udhëheqës i Divizionit për NATO si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca të Sigurisë, Juridik ose Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze ose frënge në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze ose frënge dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose frënge. Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca të Sigurisë, Shkenca Politike, Juridik, Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Kulturore dhe Sportive si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare: Arte, Gazetari, Shkenca Komunikimi, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Politike ose shkenca tjera sociale, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Publikë dhe Privilegje Diplomatie si kualifikime të posaçme janë përcaktuar; Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare: Gazetari / Shkenca komunikimi / Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Politike, Teknologji Informative ose shkenca tjera sociale, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Afrikën Nensahariane si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Juridik, Ekonomik ose Shkenca tjera shoqërore, natyrore ose teknike, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze, frënge ose arabe në nivelin B2-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhëve angleze, frënge ose arabe, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në këto gjuhë ose në një universitet jashtë vendit në këto gjuhë. Udhëheqës i Divizionit për Azinë si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Diplomë/a të studimeve universitare, në Juridik, Ekonomik ose Shkenca tjera shoqërore, natyrore ose teknike, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin B2-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare, në Shkenca të Sigurisë, Shkenca Politike, Juridik, Shkenca tjera shoqërore, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshkohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Promovimin dhe Përkrahjen

e Investimeve si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Arsimi: *Diplomë/a të studimeve universitare, në lëmin e ekonomisë, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin B2-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze. Udhëheqës i Divizionit për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar, si kualifikime të posaçme janë përcaktuar: Arsimi: *Diplomë/a të studimeve universitare, në lëmin e ekonomisë, me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale. Tjetër: Kualifikime të posaçme formale: Njohje e gjuhës angleze në nivelin B2-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze, Rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar së ankuesi nuk ka plotësuar kriteret e posaçme për asnjërën nga pozitat e lartshënuara.**

Përkitazi me ligjshmërinë e vendimit për transferimin e ankuesit në institucion tjetër të shërbimit civil, përkatësisht në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kolegji ka analizuar kualifikimet e përcaktuara për këtë pozitë pune: *Diplomë universitare në lëmin e shkencave shoqërore, juridik, së paku 5 vite përvojë punë dhe si rrjedhojë vlerëson se Vendimi me numër protokolli 1373 i datës 11.11.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë është nxjerrë në pajtim me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse është plotësuar kriteri i transferimit në kategori të njëjtë si dhe kriteri i plotësimit të kushteve dhe kualifikime për pozitën përkatëse.*

Përmbledhur si me lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBJIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1042/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit Ejup Kamberi;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

